

Watchdog Report-Gender Based Violence Municipality of Tirana

Authors: Msc. Armela Pengili and Flavia Djaloshi



Partner organization and Logo: ACT for SOCIETY Center

Mentors: Prof.Dr. Raimonda Duka

This Project is funded by UNWOMEN

“The contents of this publication are the sole responsibility of < Msc. Armela Pengili and Flavia Djaloshi and Qendres ACT for SOCIETY> and can in no way be taken to reflect the views of UNWOMEN.”

Contents

1. Hyrje	3
2. Qëllimi dhe Metodologjia e Përdorur	6
3. Konteksti institucional dhe kornizat politike	7
4. Përshkrimi i politikave të ndjekura kundër dhunës me bazë gjinore	9
5. Fushëveprimi, përfituesit, palët e interesuara	11
6. Analiza e Buxhetit dhe Gjetjet Kryesore	13
7. Përfundime dhe Rekomandime	15
8. Bibliografia	16

1. Hyrje

Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së barazisë gjinore. Që prej vitit 2005 disa programe kanë analizuar këtë çështje të përfshirë në linjat kryesore të programeve të tyre. Ndërhyrjet më të rëndësishme kanë qenë në forcimin e kuadrit ligjor (Ligji “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”, nr.9970, dt.24/07/2008) dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit rreth parimit bazë të mosdiskriminimit. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020 e vazhdojnë me një frymë pozitive këtë trend përmirësimi të aspektit ligjor dhe ekzekutiv. Vetë Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në Strategjinë e saj Kombëtare për Barazinë Gjinore e nis me:” Qeveria e Republikës së Shqipërisë i konsideron si prioritare çështjet e barazisë gjinore, luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje, të lidhura ngushtë me proceset integruese të vendit”¹.

Akoma evidentohen probleme, të cilat kanë në fokus dhunën me bazë gjinore. Problem ky i cili është shumë shqetësues në të gjithë vendin. Të dhënat që disponon INSTAT, për dhunën në familje janë alarmante, e si rrjedhojë kërkohet një analizë e situatës, se cilat janë masat që janë ndërmarrë, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal.

Të dhënat për dhunën në familje në nivel Qendror për 2017: Burimi, Instat²

	2015	2016	2017
Raste të evidentuara nga policia	3448	3695	4005
Nga të cilët të vdekur	20	16	13
Kërkesa për urdhër mbrojtje	2148	2207	2593
Autorët	3534	3845	4166

¹ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, faqe nr 6.

² Instat, Dhuna në familje

Vlen të theksohet që këto të dhëna mund të mos jenë plotësisht të sakta, pasi shumë prej viktimave të dhunës me bazë gjinore, jo gjithmonë i drejtohen autoriteteve publike, nga mungesa e besimit që kanë tek autoritetet publike apo dhe nga frika e pasojave që mund të kenë pas kallëzimit.

Fokusi i raportit do të jetë Bashkia e Tiranës.

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin, si dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Popullësia: Sipas censurit të vitit 2011³, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censurit është 502 banorë/km² ndërsa sipas Regjistrit Civil, densiteti është 682 banorë km².

Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhitë, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Shkalla e punësimit për popullsinë 16-64 është 64,3% për burrat dhe 50,3% për gratë e kesaj grupmoshe³. Struktura e të punësuarve sipas statusit aktiv tregon se 42% e grave janë të punësuar me pagë, ndërsa 23% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Për burrat e punësuar këto shifra janë përkatësisht 37% dhe 12%. Shifrat e mësipërme janë në rang kombëtar, bashkia Tiranë dhe INSTAT nuk paraqesin të dhëna për nivelin real lokal.

Situata e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Tiranë

Situata e dhunës në Bashkinë Tiranë paraqitet tepër problematike. Sipas të dhënave të marra nga Instat për vitin 2017, ku përqindja më e lartë e grave që përjetojnë dhunë në familje, është

³ Instat, Censuri i Popullsisë dhe Banesave, Tetor 2011

në qarkun e Tiranës me **35,8 %** gra të dhunuara. Numri i grave të dhunuara në raport me numrin e popullsisë në qarkun e Tiranës është i treti më i larti në Shqipëri, me normë **26,3** të dhunuara **për 10 mijë** banore gra.⁴

Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës, në faqen zyrtare të saj, disponon të dhëna përsa i përket lëshimit të urdhërave të mbrojtjes si më poshtë:

Burimi: Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë⁵

	2016	2017	2018
Lëshim urdhër mbrojtje	417	266	185
Lëshim urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes	504	767	791

Me të dhëna të tilla, Bashkia e Tiranës ka një prej niveleve më të larta të raportimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Për rrjedhojë ofrimi i shërbimeve viktimave të dhunës në familje dhe më tej edhe rritja e ndërgjegjësimit popullsisë për të mos pranuar dhe toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje duhet të jetë objektiv parësor për veprimtarinë e bashkisë në këtë fushë.

Duhet vënë në dukje fakti që për vitin 2018 situata paraqitet akoma dhe më shqetësuese, duke marrë parasysh që numri i lëshimit të urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes është nw rritje, dhe parashikohet që mund të rritet më shumë, pasi kjo e dhënë është deri në 31 Tetor 2018, ku mbeten dhe dy muaj të tjerë, për mbylljen e vitit 2018.

⁴ Instat, Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2017

⁵ Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë

Në këto kushte me një situatë në të cilën dhuna në familje vazhdon të mbajë të njëjtat ritme përhapje, të njëjtat shkaqe ushtrimi, është e nevojshme lufta kundër këtij fenomeni jo vetëm nga ana e OJF-ve, por dhe nga vetë Njësitë e qeverisjes vendore.

Në një vështrim të planit buxhetor për vitin aktual dhe dy vitet në vijim, Bashkia e Tiranës ofron shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore përmes buxhetimit të organizatës Qendra Komunitare Shkozë e cila ofron shërbime të ndryshme për fëmijët, **gratë e dhunuara** dhe për të moshuarit, si dhe Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët” e cila ofron shërbime psiko-sociale dhe mbështetje për persona të vetmuar, të moshuar, fëmijë të rrugës, **gra të dhunuara të vetmuara dhe të divorcuara.**

2. Qëllimi dhe Metodologjia e Përdorur

Për të kryer monitorimin e shërbimeve që i ofrohen viktimave të dhunës me bazë gjinore u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

- Mbledhja e të dhënave u bë në bashkëpunim me Zyrën për Barazinë Gjinore dhe Diskriminimin pranë Bashkisë Tiranë;
- Gjithashtu në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë arritëm të merrnim info për shërbimet që ofrohen, si dhe PBA 2018-2020 e cila është gjithashtu në faqen zyrtare;
- Është analizuar Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020;
- Është analizuar Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020 Bashkia Tiranë;
- Janë marrë të dhëna statistikore pranë INSTAT për dhunën me bazë gjinore;
- Të dhëna statistikore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë

3. Konteksti institucional dhe kornizat politike

Sanksionimi me ligj i barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit (Neni 18 i Kushtetutës), bën që burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, de jure të trajtohen njësoj, në mënyrë të barabartë dhe si pasojë të kenë edhe detyrime të njëjta. Barazia përshkon të gjithë Kushtetutën dhe ligjet e tjera. Një sërë Kodesh të miratuara pas vitit 1995, përmbajnë dispozita në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sanksionojnë parimin e barazisë burrë-grua: Kodi Civil, Kodi Penal, Kodi i Familjes dhe Kodi i Punës. Shqipëria ka ratifikuar Konventën “Për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas” në vitin 1993. Sipas detyrimeve që ka, Shqipëria ka raportuar pranë Komitetit të Konventës në janar 2003 dhe tani është në fazën e përmbushjes së rekomandimeve të bëra nga Komiteti i Konventës, sikurse dhe në përgatitjen e raportit të tretë periodik zyrtar. Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri plotëson kuadrin ligjor lidhur me barazinë gjinore në arsim, punësim dhe vendim-marrje. Ai mundëson ngritjen e mekanizmave qeveritarë në hartimin e politikave për barazinë gjinore dhe parashikon matjen e ndikimit të këtyre politikave nëpërmjet vlerësimeve dhe monitorimit periodik. Megjithatë, gratë janë një nga grupet që vuajnë më shumë nga pasoja e tranzicionit social dhe ekonomik. Pabarazia gjinore mbetet një shqetësim real, si rezultat i traditës gjinore dhe mendësisë maskiliste të shoqërisë, duke vënë një pjesë të grave në dilemë, për përmbushjen e përgjegjësiive familjare apo për karrierë. Politikat kryesore për zbutjen e kësaj në mënyrë të vecantë, lidhen edhe me mbrojtjen e grave të trafikuar apo në rrezik trafikimi e të dhunuara.

Gjithashtu një tjetër nismë e qeverisë është dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020, ku një ndër parimet kryesore të kësaj strategjie është dhe “Tolerancë Zero kundrejt dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional”. Qëllimi strategjik numër 3 i këtij dokumenti strategjik, “Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, e mbështet plotësisht dhe parimin e tolerancës zero kundrejt dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.⁶ Qëllim ky i

⁶ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020

ndjekur nga një sërë objektivash dhe aktiviteteve që synojnë plotësimin e këtij qëllimi brenda vitit 2020.

Bashkia Tiranë aktualisht ka një plan veprimi për Barazinë Gjinore 2018-2020, i cili është një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Tiranë në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Ky plan u përgatit si hap i parë i zbatimit në praktikë të Kartës Europiane për Barazi të Burrave dhe Grave në jetën vendore.

Plani vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave, si dhe të rejave e të rinjve në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të vecanta të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Vëmë re se si objektiv specifik i këtij plani veprimi, përfshihet edhe objektivi 3.7 i cila ka në fokus dhunën ndaj grave, më specifikisht: “Të rritet efektiviteti i qasjes shumë sektoriale dhe shërbimeve bazë të specializuara për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore”⁷, i cili gjithashtu shoqërohet me aktivitete konkrete se si do të arrihet.

Bashkia Tiranë ekziston dhe operon në një kontekst institucional dhe në një kornizë ligjore të mirëpërcaktuar . Më poshtë po citoj ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”⁸ mbi të cilin operon Bashkia Tiranë dhe gjithë njësitë e tjera vendore të Republikës së Shqipërisë. Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Nëpërmjet Nenit 2 të këtij ligji, citohet qartazi misioni i

⁷ Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2018-2020, Bashkia Tiranë

⁸ Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

vetëqeverisjes vendore, për të siguruar një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Në nenin 24 të këtij ligji, përcaktohet se “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.⁹ Këto funksione dhe përgjegjësi të reja nxjerrin në pah edhe nevojën e një procesi gjithëpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendor, duke shtuar këtu edhe zgjerimin e territorit dhe popullatës që Bashkia duhet të mbulojë me shërbime.

Bashkia Tiranë ka ndërmarrë një sërë hapash konkretë në krijimin e mekanizmave kundër dhunës me bazë gjinore.

Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit për 2016-2020, në qëllimin Strategjik numër 3, objektivi 3.2 thuhet se “Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.”. Në kuadër të këtij objektivi, Bashkia Tiranë, ka tashmë një mekanizëm referimi për dhunën me bazë gjinore, i cili është funksional.

4. Përshkrimi i politikave të ndjekura kundër dhunës me bazë gjinore

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” dhe ndryshimeve të tij në vitin 2007 dhe 2010 u ndërmorr një hap i rëndësishëm drejt plotësimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Dy ndër objektivat kryesorë të këtij Ligji ishin ai krijimit një rrjeti të bashkërenduar të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, dhe për zbutjen e pasojave të dhunës në familje dhe parandalimin e saj si dhe të sigurojë/garantojë që viktimave të dhunës t’u ofrohen shërbime të shpejta, jo të kushtueshme, dhe të thjeshta nga

⁹ Ligji 134/2015, neni 24 për Vetëqeverisjen Vendore

gjykatat dhe organet e tjera ligj-zbatuese në përputhje me ligjin.

Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri plotëson kuadrin ligjor lidhur me barazinë gjinore në arsim, punësim dhe vendim-marrje. Ai mundëson ngritjen e mekanizmave qeveritarë në hartimin e politikave për barazinë gjinore dhe parashikon matjen e ndikimit të këtyre politikave nëpërmjet vlerësimeve dhe monitorimit periodik.

Gjithashtu një tjetër nismë e qeverisë është dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020, ku një ndër parimet kryesore të kësaj strategjie është dhe “Tolerancë Zero kundrejt dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional”.

Bashkia Tiranë, në mbështetje të kuadrit ligjor ndërkombëtar e kombëtar, si dhe të prioriteteve kombëtare dhe vendore, ka bërë përpjekjet e saj ndër vite për ndërtimin e një shoqërie të mundësive të barabarta, duke ndërmarrë një sërë hapash konkretë në këtë drejtim.

Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore menaxhon dhe ndihmon rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor, koordinim me të gjithë aktorët e rrjetit, këto në interes të viktimës.

Bashkia Tiranë, në zbatim të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar, VKM-së nr. 334, datë 17.02.2011 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të Tij”, ka ngritur Mekanizmin e Referimit në Tiranë në maj 2012

Fuqizimi i mekanizmit vendor për barazinë gjinore me ngritjen e Komisionit për Barazinë Gjinore dhe Sipërmarrjen e Gruas në nivel të Këshillit Bashkiak në shtator të vitit 2015, fuqizimi i Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, ngritja e Aleancës së Grave Këshilltare, apo ngritja e fondit për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes, janë vetëm disa nga veprimet e ndërmarra nga Bashkia Tiranë këto tre vitet e fundit. Por, barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në praktikë, në jetën e përditshme, është ende larg të qenit realitet. Në kuadër të nënshkrimit të Kartës Europiane për Barazi Gjinore, është hartuar Plani i Veprimit për Barazinë gjinore 2018-2020, Bashkia Tiranë.

Në këtë Plan vendor Veprimi propozohen të tjera masa e veprime që synojnë adresimin e mëtejshëm të çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit. Të gjitha këto masa dhe veprime mbështeten në nenet përkatëse të Kartës Evropiane për Barazi, pa lënë mënjanë edhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016 - 2020 dhe Planit të saj të Veprimit.

5. Fushëveprimi, përfituesit, palët e interesuara

Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore menaxhon dhe ndihmon rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor, koordinim me të gjithë aktorët e rrjetit, këto në interes të viktimës.

Ky Mekanizëm reagon menjëherë dhe me përgjegjësinë e duhur me shërbimet e mëposhtme të cilat janë FALAS për të mbijetuarat e dhunës në familje:

- Mbështetje multidisiplinare për të mbijetuarat/it e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- Strehim social (bonus qiraje, mbulim qiraje 2-3 muaj nga organizata bashkëpunëtore);
- Këshillim psikologjik dhe ligjor;
- Mbështetje të rasteve të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse: Gjykatë, Polici; Përmbarrim, Prokurori etj;
- Aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese të komunitetit;
- Linjën Kombëtare të Këshillimit 24 orëshe 116 117 pritëse, këshilluese dhe referuese të rasteve të dhunës në familje;
- Këshillim për djem dhe burra përmes Linjës së Këshillimit për Djem dhe Burra;
- Paketa të ndryshme ushqimore, veshmbathje, higjeno-sanitare etj.

Mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar (ETN-së)

Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, gjatë periudhës Janar-Shtator 2018 në rolin e koordinatorit të Mekanizmit të Referimit, ka organizuar mbledhje periodike të Ekipit

Teknik Ndërdisciplinar (ETN). Në këto mbledhje marrin pjesë përfaqësuesit e 15 institucioneve pjesë të Mekanizmit të Referimit, duke përfshirë Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza si dhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem konkretisht:

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë,
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
3. Prokuroria e Rrethit Tiranë,
4. Zyra e Përmbartimit Tiranë,
5. Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë,
6. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë,
7. Spitali (QSUT) Tiranë,
8. Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë,
9. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë,
10. Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë,
11. Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë,
12. Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”.
13. Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
14. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
15. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Të gjitha rastet e dhunës në familje që paraqiten dhe kërkojnë ndihmë, në cilindo prej institucioneve të sipërpërmendura, trajtohen në mënyrë të menjëhershme, me efektivitet dhe duke iu ofruar shërbime multidisiplinare.

Bashkia Tiranë ka miratuar një **Procedurë Standarde Veprimi** për mbrojtje nga dhuna në familje në fillim të vitit 2018 e cila qartëson rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegritimit

Gjatë periudhës **Janar-Shtator 2018**, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me institucionet dhe

OJF-të pjesë të Mekanizmit të Referimit ka mbështetur **73 raste** të dhunës në marrëdhëniet

familjare. **1078 raste të DHF të trajtuara për periudhën 2015-2017 nga Bashkia Tiranë.**

6. Analiza e Buxhetit dhe Gjetjet Kryesore

Në PBA 2018-2020, në 11 programet buxhetore, nuk arritëm të identifikonim një program të posacëm për dhunën me bazë gjinore. Programi i Kujdesit Social dhe Solidaritetit përfshin shpenzime për: Qendra Sociale Multidisiplinare, Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”, Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, Qendra Komunitare Shkozë. Të gjitha këto qendra kanë në fokus familjet në nevojë, fëmijët jetimë, familjet rome, si dhe **gratë e dhunuara** etj.

Shërbimet e ofruara për gratë nga Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”

Kjo Qendër ofron shërbime sociale ditore në mbështetje të grupeve në nevojë me qëllim përmirësimin e mirëqënies sociale, fizike, emocionale dhe edukative të tyre. Një nga target grupet që marrin shërbim në qendër janë edhe grate e divorcuara apo me probleme të tjera sociale si dhuna. Numri i grave përfituese është 45 por nga këto gra të divorcuara, të vetmuara dhe endacake janë 23.

Ndihma ndaj tyre konsiston në mbështetjen e plotë psiko-sociale, terapi këshillimi dhe individuale, konsumimin e vaktit të drekës dhe darkës dhe shërbimeve të tjera sipas rastit. Në disa raste i është dhënë ndihmë e llojit asistencë ligjore apo spitalore duke i shoqëruar deri në zgjidhjen e çështjeve që ato kanë hasur vështirësi nëpër institucionet e tjera.

Shërbimet e ofruara për gratë nga Qendra Komunitare Shkozë

Q. K. SH është një qendër multidisiplinare dhe fokusohet në veprimin e drejtpërdrejtë dhe praktik për të përmirësuar jetën e familjeve në nevojë, e fëmijëve në risk dhe moshës së tretë.

Një nga kategoritë që trajtohen në Qendrën Sociale Shkozë janë gratë e dhunuara dhe në Shkozë numri i grave të dhunuara është **3 (tre)**. Kjo kategori orientohet dhe shoqërohet për të marrë Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje pranë komisaritit më të afërt, ndiqen procedurat për të përfituar Urdhër të Mbrojtjes në Gjykatë dhe referohet pranë njësive përkatëse për të përfituar pagesën.

Për procedurat e divorcit referohen pranë shërbimit ligjor falas Tlas dhe nga Q.K.Sh kemi një rast të referuar për zgjidhje martesë. Pas zgjidhjes së martesës është ndjekur rasti për përfitimin bonusit të qirasë i cili është realizuar. Për fuqizimin e familjes lobohet me organizata të ndryshme për të mundësuar punësimin e rastit.


Ofrohet këshillim psikologjik individual dhe familjar në rastet kur punohet me të gjithë familjen.

Mbështetje psiko-sociale për integrimin social të fëmijëve dhe grave. Zhvillohet dhe terapi Arti me gra dhe vajza për eksplorimin e ndjenjave dhe ekuilibrimin emocional të tyre.

PBA 2018-2020 “Programi i Kujdesit Social dhe Solidaritetit në mijë lekë”¹⁰

	2018	2019	2020
Aparati i Bashkisë	173500	303500	315500
Qendra Sociale Multidisiplinare	26800	26800	26900
Qendra Komunitare “Të qëndrojmë sëbashku”	33300	33300	33300
Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”	29200	29200	29500
Qendra Komunitare “Shkozë”	31200	31200	31700
Total	294000	424000	436900

Shpenzimet totale për këtë program janë 294’000 për vitin 2018, pra **2.1% e totalit të Buxhetit**. Ecuria e shpenzimeve për këtë program për periudhën 2018-2020 jepet si vijon:



¹⁰ PBA 2018-2020, Bashkia Tiranë

Pra sic shihet, kemi një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve për këtë program në vitet në vazhdim, 2019 dhe 2020.

Gjithashtu, sipas informacioneve të marra në mënyrë elektronike nga Bashkia Tiranë, për bonuset e strehimit, numri i grave të dhunuara të cilat kanë qenë dhe janë përfituese të bonusit të strehimit përgjatë viteve 2016-2018, është **11**, ose është përdorur **4%** e buxhetit. Të gjitha rastet e kanë përfituar bonusin në masën 100%.

Duhet theksuar që numri i rasteve të dhunës që kanë aplikuar për Bonus Qiraje pranë Bashkisë Tiranë është më i madh se 11, por ato nuk kanë arritur ta përfitojnë për shkak se nuk kanë pasur vendim gjykatë të divorcit. Për mos plotësim dokumentacion ato janë përjashtuar nga skema e strehimit social të Bashkisë Tiranë.

7. Përfundime dhe Rekomandime

Përfundime:

- Bashkia Tiranë nuk ka një qendër të specializuar vetëm për viktimat e dhunës me bazë gjinore;
- Jo të gjitha shërbimet e ofruara nga Bashkia Tiranë janë efektive;

Rekomandime:

- Pjesa më e madhe e shërbimeve ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile. Për rrjedhojë duhet rritur më tej bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave për të krijuar mekanizma të përbashkët për ofrimin e shërbimeve
- Bashkia e Tiranës duhet të jetë më aktivisht e angazhuar në rritjen e ndërgjegjësimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
- Duhet të zhvillohen paketa sa më të plota shërbimesh të integruara për viktimat e dhunës me bazë gjinore.
- Të gjithë instituconet e MR duhet të fitojnë paralelisht njohuri të përbashkëta e të kenë qartësi në përgjegjësitë e tyre dhe kolegëve në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të DHF&DHBGJ.

8. Bibliografia

<http://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

<http://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>

<http://www.tirana.al/publikime/buxheti/>

<https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/05/%E2%80%9CMonitorim-i-Mekanizmit-t%C3%AB-Referimit-p%C3%AB-rastet-e-Dhun%C3%ABs-n%C3%AB-Familje-n%C3%AB-nivel-lokal-aktiviz%C3%ABm-qytetar-p%C3%AB-p%C3%ABmir%C3%ABsimin-e-tij%E2%80%9D.pdf>

<http://www.financatvendore.al/buxhetet>

<http://www.instat.gov.al/al/search/?query=burrat+dhe+grate>

<http://www.tirana.al/wp-content/uploads/2016/06/Ligji-per-Vetqeverisjen-Vendore.pdf>